



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 06

Datë: 08. 02. 2020. Ora: 14:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniqi, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve nr.4 dhe 5/ 2020

2.Raporti i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë, që do të mbahen më 15 mars, 2020.
- Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë.
- Shqyrtimi dhe miratimi i projektit për Informim Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Podujevës, që do të mbahen më 15 mars, 2020.
- Miratimi i Këshillit Mbikqyrës të Informimit Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë, që do të mbahen më 15 mars, 2020.

3. Këshilli për Buxhet dhe Financa

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë, që do të mbahen më 15 mars, 2020.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së, dhe stafit të SKQZ-së.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për Ministrinë e Financave – Departamenti i Thesarti, lidhur me përfundimin e mandatit ëpr ish anëtarët e KQZ-së.

6. Të ndryshme

1. Hvrje: znj. Valdete Daka, Krvesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Përshëndetje, e hapi mbledhjen e gjashtë të KQZ-së...! A keni vërejtje, propozime...? Nëse nuk keni, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Meqë, vazhdoi znj. Daka, janë shpallë zgjedhjet për komunën e Podujevës, uroj qytetarët për këto zgjedhje, dhe ju dëshiroj të gjithëve zgjedhje të qeta, të rregullta, dhe kandidatëve sukses...

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhja nr. 4 dhe 5 nga mbledhjet e KQZ-së.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalet nga mbledhjet nr.4 dhe 5 të KQZ-së, pa ndonjë vërejtje.

3. Raportet e Këshillave të KOZ-së.

Këshilli për Operacione Zgjedhore

3.1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit Operacional për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë, që do të mbahen më 15 mars, 2020.

Alim Rama, kryesues i KOZ-it, tha se këshilli ka shqyrtuar planin operacional të përgatitur nga Sekretariati për çka, edhe e falënderoj Sekretariatit për punën e bërë në një afat të shpejtë. Ne, tha z. Rama, rekomandojmë që plani të aprovohet, gjithsesi duke i marrë parasysh edhe disa vërejtje të OSBE-së, dhe të organizatave vendore... Ne, tha ai, i kemi aplikuar aty ku e kemi parë të arsyeshme...!

Valdete Daka: Periudha e fushatës, sipas këtij plani, do të jetë 11 ditë, dhe do të zgjas nga data 3 mars, deri më 13 mars, ndërkaq aplikimi për akreditim të vëzhguesve do të filloj nga data 14 mars,

deri më 12 mars, aplikimi i subjekteve politike për certifikim fillon më 8 shkurt, deri më 17 shkurt...Plani, do të jetë në ueb faqe...

Eshref Vishi: Unë mendoj se administrata duhet ta shtoj efikasitetin e punës së saj, me qëllim të përmbushjes së aktiviteteve të planit operacional zgjedhor. Ka shumë punë, dhe shumë aktiviteteve. Administrata, tha z. Vishi, e ka përvojën nga shumë zgjedhje të cilat janë organizua, qoftë në nivelin lokal, dhe qoftë qendrore...Kam rezervat e mia te fushata: kemi vetëm një komunë, dhe nuk kemi shumë komuna, do t'ishte mirë që ky afat të jetë më i reduktuar, megjithatë KOZ e ka shqyrtuar k'të punë, por unë mendoj se më efikas dhe më funksional do t'ishte sikur afati t'ishte më i reduktuem...

Valdete Daka: Mbase, jemi nisur nga rekomandimet e BE-së, ngase subjektet politike që kur shpallen zgjedhjet e nisin njëfarë fushate, por nëse ka ndonjë kërkesë tjetër...

Alim Rama: Raporti i BE-së, ka qenë si vërejtje që fushatat janë të shkurtër...ndërsa, datat në plan janë të harmonizuara me planin operacional, pra janë datat maksimale dhe nuk ka arsye me u shkurtue...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan planin operacional për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë, që do të mbahen më 15 mars, 2020, fillimisht duke i shkurtuar afatet në përputhje me rrethanat operationale.

3.2.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë.

Alim Rama: Këshilli, i ka shqyrtuar afatet dhe unanimisht, i ka aprovuar për rekomandim.

Valdete Daka: E keni draft vendimin... ! Këto, janë afatet:

- *Aplikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve fillon më 8 shkurt dhe më 17 shkurt 2020.*
- *Tërheqja e shortit për renditjen e subjekteve politike dhe kandidatëve në fletëvotim do të mbahet më 2 mars 2020.*
- *Periudha e aplikimit për t'u regjistruar votues jashtë Kosovës fillon më 16 shkurt dhe përfundon më 23 shkurt 2020.*
- *Periudha e votimit përmes postës fillon më 3 mars dhe përfundon më 13 mars 2020.*
- *Periudha e aplikimit për t'u regjistruar votues me nevoja të veçanta fillon më 26 shkurt dhe përfundon më 1 mars 2020.*
- *Fushata Zgjedhore për subjektet politike dhe kandidatët fillon më 3 mars dhe përfundon më 13 mars 2020.*
- *Afati për aplikim për akreditim të vëzhguesve të subjekteve politike dhe OJQ-ve fillon më 14 shkurt dhe përfundon më 10 mars 2020.*

- Afati për aplikim për akreditim të vëzhguesve ndërkombëtarë të zgjedhjeve dhe mediave fillon më 14 shkurt dhe përfundon më 12 mars 2020.
- Periudha për formimin e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve fillon më 8 shkurt dhe përfundon më 14 shkurt 2020.
- Periudha për formimin e Këshillave të Vendvotimit fillon më 25 shkurt dhe përfundon më 6 mars 2020.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht afatet e aktiviteteve zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë.

3.3.Shqyrtimi dhe miratimi i projektit për Informim Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Podujevës, që do të mbahen më 15 mars, 2020.

Alim Rama: Këshilli, e ka shqyrtuar këtë projekt, dhe ne i rekomandojmë KQZ-së për ta miratuar.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht projektin për Informim Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Podujevës, që do të mbahen më 15 mars, 2020.

3.4.Miratimi i Këshillit Mbikëqyrës të Informimit Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë, që do të mbahen më 15 mars, 2020.

Valdete Daka: Për Këshill Mbikëqyrës të Informimit Publik, janë propozuar:

Arianit Elshani – kryesues,

Alim Rama, anëtarë,

Artan Asllani, anëtarë,

Valmir Elezi, SKQZ,

Valmira Selmani, SKQZ.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht Këshillin Mbikëqyrës të Informim Publik për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Podujevës, që do të mbahen më 15 mars, 2020.

3. Këshilli për Buxhet dhe Financa

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë, që do të mbahen më 15 mars, 2020.

Sami Hamiti: Ju përshëndes të gjithëve ! Ne, sot në këshill kemi analizue planin mirë, pra kemi pas një prezentim të mirë nga Sekretariatit. Për herë të parë, kemi parë edhe stoqet që kanë mbetë nga zgjedhjet tjera, dhe kjo lidhet me material që do të përdoret në ditën e zgjedhjeve, dhe nuk do të jenë pjesë nga rezervat, pra që të mos kemi shpenzime... Plani e ka buxhetin, është projeksioni edhe për balotazhin eventual, pra janë mjetet...Unanimisht e kemi votuar në këshill, dhe ne propozojmë KQZ-së për ta aprovuar, dhe të procedohet menjëherë në Qeveri...Pra, ne kërkojmë të aprovohet...

Arianit Elshani: Pas shqyrtimit të planit, mendoj që është imediate nevoja për ta miratuar buxhetin sa më shpejt dhe, kjo hapë rrugë për implementimin e planit...Por, lidhur me shtesat jam dakord që ato të bëhen sidomos për anëtarët e Sekretariatit, por për anëtarët e KQZ-së, jam kundër që të ketë shtesë për anëtarët...

Sami Hamiti: Asnjë lëvizje nga përvojat e kaluara të zgjedhjeve, nuk ka ndryshim dhe, është mirë që, të mos bëjmë lëvizje dhe, në projekt buxhetin nuk ka lëvizje...

Arianit Elshani: Unë po kërkoj largimin e privilegjeve për anëtarët e KQZ-së...

Sami Kurteshi: Sa i përket propozimit që e dha kolegu, po e shoh që nuk kanë lëvizur...Edhe unë mendoj që për përfaqësuesit politik nuk janë të nevojshme shtesat, dhe pajtohem që ato të hiqen...!

Lidhur me këtë pikë, diskutuan më tutje edhe: Alim Rama, Yll Buleshkaj (Sekretariati), Sami Hamiti, dhe Ibrahim Selmanaj.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan Planin të Buxhetit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Podujevë, që do të mbahen më 15 mars, 2020. (7 vota për, 1 kundër, dhe 1 votë abstenim)

4.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së, dhe stafit të SKQZ-së.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan edhe orarin e zgjatur të punës, si për Sekretariatit ashtu edhe për KQZ-në – një praktikë kjo tashmë standarde për proceset zgjedhore.

5.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për Ministrinë e Financave – Departamenti i Thesarti, lidhur me përfundimin e mandatit për ish anëtarët e KQZ-së.

Valdete Daka: Kjo, është një çështje e moçme, dhe nga Thesari ne nuk kemi me i heqë nga lista e pagave anëtarët të cilëve, edhe u ka kaluar afati. Mirëpo, ne nuk jemi ata që i kemi nominuar. Dhe, numri i tyre ka ardh deri në rreth 30, edhe pse ata kanë zero pagë! Prandaj, Thesari nuk na lejon ne të marrim anëtarë të rijne...dhe ne, jemi të detyruar të marrim një vendim...

Pra, kush është për që ne të marrim një vendim...!

Anëtarët e KQZ-së, morën vendim që ish anëtarët e KQZ-së të hiqen nga lista e pagave.

6.Të ndryshme

Eshref Vishi: Këshillat, tashmë ne i kemi themeluar por, është mirë që materialet të procedohen me kohë në mënyrë që të kemi mundësi dhe hapësirë para takimeve t'i lexojmë ato, dhe t'i procedojmë...

Valdete Daka: Po, sigurisht, mirëpo këto sot ishin çështje urgjente...